<p>Bashkia Shkoder gjate vitit organizon aktivite ne kuader te perkujtimit te disa datave dhe momenteve me rendesi historike per Shkodren dhe Shqiperine.</p> <p>1. “Java e Pavarësisë dhe e Çlirimit” Java e Pavarësisë dhe e Çlirimit organizohet nga Bashkia e Shkodrës me përfshirjen e institucioneve të kulturës, organizata e qytetarë.Viti 2024 perkon me 112 vjetorin e pavaresise se Shqiperise ku do te organzohet ceremonia e Ngritjes se Flamurit ne sheshin para Bashkise Shkoder e cila shoqerohet nga Orkestra Frymore e Bashkise Shkoder. Gjithashtu kete vit eshte edhe 80 vjetori I clirimit te Shqiperise dhe do te zhvillohet nje takim I cili do te finalizohet me nje ekspozite . “Java e Pavarësisë dhe e Çlirimit” eshte planifikuar shpenzime per honorare ne vleren 30 mije leke.</p> <p>2. “Aktivite me rastin e 2 Prillit “ 2 Prilli 1991 në Shkodër nisën si një protestë qytetare kundër regjimit më të egër komunist që njohu Europa. Ajo ditë shënjoi për Shkodrën dhe të gjithë Shqipërinë të ardhmen e vendit. Bashkia Shkodër në respekt të ketij momenti historik organizon çdo vit aktivitet për kujtimor të asaj ngjarjeje. Aktiviteti perkujtimor dhe ceremonia e vendosjen se kurorave shoqerohet nga Orkestra Frymore e Bashkise Shkoder Per kete aktivitet eshte planifikuar shpenzime per honorare dhe vendosjen e kurorave ne vleren 32 mije leke.</p> <p>3. “Lëvizja e Postribës” E njohur si lëvizja e pare anti komuniste në Shqipëri,e ndodhur më 9 shtator 1946. Bashkia Shkodër e për kujton çdo vit datën 9 shtator duke organizuar homazhe dhe vendosje kurorash ne nderim te kesaj date historike. Aktiviteti perkujtimor dhe ceremonia evendosjen se kurorave shoqerohet nga Orkestra Frymore e Bashkise Shkoder. Per kete aktivitet eshte planifikuar shpenzime per transportin e trupës se bandës frymore në Postribë dhe vendosjen e kurorave me lule ne vleren 15 mije leke,</p> <p>4. “5 Maji ” Per kete aktivitet eshte planifikuar shpenzime per transportin e trupës se bandës frymore në Postribë dhe vendosjen e kurorave me lule ne vleren 15 mije leke,</p> <p>Gjate vitit 2024 do te behet detajimi i buxhetit sipas kalendarit dhe do te percaktohet menyra e realizimit te aktivitetit,ne menyre që këto aktivite të realizohen në nivat më të larta profesionale, duke I dhënë rëndësinë e duhur të gjithë komponentëve teknik.</p>		
ii. Synimi i projektit		
<p>Evidentimi i vlerave dhe fakteve historike, kulturore e të trashigimisë në periudha te ndryshme te Shkodres. Njohja e publikut, kryesisht e të rinjve, me këto fakte historike e dëshmi, përmes ekspozimit artistik në muze.</p>		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<p>Përzgjedhja e materialeve që do ekspozohen; Kurimi i fondit të objekteve në funksion të ekspozimit; Përgatitja e materialeve promocionale për aktivitetin;</p>		
b) Rezultatet që prisni		
<p>Ruajtja dhe përcjellja e historisë dhe vlerave të trashëgimisë kulturore dhe historike; Nxitja e studimeve ndaj këtyre çështjeve në ditët e sotme; Rikthimi i vëmendjes së publikut tek këto elemente të veçantë të trashëgimisë kulturore.</p>		
d) Kontributet e mundshme në projekt		
<p>Stafi i Muzeut; Vizitorët; Studentët e Universitetit “Luigj Gurakuqi”; Studiues dhe bashkëpunëtorë të Muzeut;</p>	<p>Bashkia Shkodër, Donatorë të mundshëm Institucioni Likuidues:Bashkia Shkoder</p>	
e) Shpenzimet e llogaritura		



Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Opera tive	Transfe rime	Kapit ale
A.1	Realizimi I aktiveteteve	92			92		
	Shuma	92			92		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Opera tive	Transfe rime	Kapit ale
A.1	Realizimi I aktiveteteve	92			92		
	Shuma	92			92		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Opera tive	Transfe rime	Kapit ale
A.1	Realizimi I aktiveteteve	92			92		
	Shuma	92			92		
f) Periudha e zbatimit Gjatë vitit 2024 Gjatë vitit 2025 Gjatë vitit 2026		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria Ekonomike e Kulturës Muzeu Historik, Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit Institucioni Likuidues: Bashkia Shkoder					

Nr 6	P08220.Q1.O1.A6 Realizimi i aktiviteteve te institucioneve te trashegimise kulturore	Funksioni 8 Argëtim, Kultura dhe Feja N/funksioni 082 Shërbime kulturore Lloji i programit 08220 Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>Institucione t trashegimise kulturore organizojne nje sere aktivitetesht gjate vitit.</p> <p>Dita Ndërkombëtare e Muzeve zhvillohet çdo vit më 18 Maj.</p> <p>Ky aktivitet që u zhvillua në muzeun “Oso Kuka”, pati interes shumë të madh për publikun, studiuesit dhe mediat, për vetë faktin e përzgjedhjes nga ana jonë e figurës emblematike të Arshi Pipës, veprën e plotë të të cilit Muzeu Historik e ka në fondet e veta si një aset të rrallë, të dhuruar nga vetë autori. Per kete aktivitet eshte planifikuar shpenzime per honorare per studiues ne vleren 20 mije leke</p> <p>“Narracioni, fotografia dhe përvoja e Kujtesës” .Organizimi i veprimtarive kulturore është pjesë e pandarë e veprimtarive të bibliotekave, sidomos atyre publike, të cilat nëditët e sotme nuk janë thjesht vende të kërkimeve shkencore, por ata përipiqen të gjejnë forma dhe mënyra të reja për të ndikuar në jetën intelektuale, kulturore dhe shoqërore të njerëzve. Forumet dhe bisedat aktivitete kulturore, që në bibliotekën tonë zhvillohen prej shumë vitesh. Këto forume dhe biseda kanë lindur nga kërkesa dhe nevoja e vetë qytetarëve. Këto forume dhe biseda kanë si qëllim trajtimin dhe diskutimin e çështjeve të ndryshme të aspektit kulturor që kanë të bëjnë me librin, dijen, letërsinë, historinë, përkthimin etj. Ideja e krijimit të këtij aktiviteti është për të bërë të mundur kontaktin e drejpëdrejtë të studiuesve, krijuesve, historianëve, përkthyesve me lexuesit dhe personat e interesuar. Këto forume dhe biseda do të shtrihen gjatë gjithë vitit, në mënyrë që të ketë interes dhe vazhdimë. Biblioteka Publike `Marin Barleti` në bashkëpunim me aktorë të tjerë apo institucione simotra të interesuara për këtë temë, në qytet. Institucionet studimore dhe shkencore si dhe studiuesit nuk kanë mundësi reale që në qytet të kenë akses në informacione apo të dhëna të strukturuar në lidhje me dokumentat e shkruar dhe ato vizuale. Per kete aktivitet eshte planifikuar shpenzime per honorare , akomodim, shpenzim per realizim konference dhe botime ne vleren 350 mije leke.</p> <p>Aktivite per Femije Letërsia për fëmijë është një ndër zhanret më të veçanta të letërsisë. Vitet e fundit ajo është zbehur shumë dhe ka mungesë të theksuar të shkrimtarëve që e lëvrojnë këtë zhanër. Në qytetin e Shkodrës ka shumë të rinj dhe të reja të cilët lëvrojnë gjini të ndryshme të letërsisë.</p> <p>Në periudhat nëntor-dhejtör të vitit 2023, u zhvillua aktiviteti i cili kishte në fokus njohuritë mbi Letërsinë për Te Rinj. Qëllimi i këtij propozimi është nxitja e fëmijëve drejt librit dhe bibliotekës si tempull i librit. Aktiviteti do të zhvillohet në Bibliotekën «Marin Barleti», i ndarë në disa muaj, në formën e workshop-eve të ofruara falas për fëmijë nga mosha 5-12 vjeç. Aktiviteti do të realizohet në bashkëpunim me të gjithë parashkollorët dhe shkollat nëntëvjeçare të territorit të Bashkisë Shkodër dhe autorëve të cilët e shkruajnë dhe e zhvillojnë letërsinë për femije. Per kete aktivitet eshte planifikuar shpenzime per honorare ,shpenzim per promocion ne vleren 120 mije leke.</p> <p style="text-align: center;">LISTA E HONRAREVE</p> <table style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <tr> <td>HONORARE STUDIUES I</td> <td style="text-align: right;">15 mije leke</td> </tr> <tr> <td>HONORARE STUDIUES II</td> <td style="text-align: right;">20 mije leke</td> </tr> </table>			HONORARE STUDIUES I	15 mije leke	HONORARE STUDIUES II	20 mije leke
HONORARE STUDIUES I	15 mije leke					
HONORARE STUDIUES II	20 mije leke					
ii. Synimi i projektit						
Biblioteka Publike `Marin Barleti` në bashkëpunim me Muzeun e Fotografisë `Marubi` organizojnë këtë konferencë me synim bashkëveprimin dhe bashkërendimin e synimeve të secilit institucion me qëllimin e përbashkët të krijimit të një klime bashkëpunimi në mënyrë që t'i vijin në ndihmë institucioneve studimore, personave të interesuar , studiuesve apo kërkuesve shkencorë sa i përket studimeve apo interesave të ndryshme kulturore në të mirë të njohjes së të shkuarës, si dhe formësimit të Kujtesës si një strukturë e formësuar dhe solide.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
Konference me sesione të përcaktuara Ngritje e një grupi të përbashkët pune Vizitë njohëse dhe vlerësuese nëpër institucionet kulturore në qytet si dhe në zonat muzeale						
b) Rezultatet që prisni						
Formësim i një praktike të përbashkët e cila do t'i vijë në ndihmë institucioneve dhe studiuesve apo personave të interesuar brenda dhe jashtë vendit, në lidhje me Kujtesën, nëpërmjet dokumentit të shkruar dhe atij vizual.						
d) Kontributet e mundshme në projekt						



Komuniteti i shkrimtarëve, gjuhëtarëve, studiuesve dhe i lexuesve që preferojnë gjuhën, leximin dhe përdorimin e gjuhës geqe.		Bashkia Shkodër.				
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Siguri me	Opera tive	Transfe rime
A.1	Realizimi I aktiveteteve te trashegimise kulturore	490			490	
	Shuma	490			490	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Siguri me	Opera tive	Transfe rime
A.1	Shpenzime për aktivitetin	490			490	
	Shuma	490			490	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Siguri me	Opera tive	Transfe rime
A.1	Shpenzime për aktivitetin	490			490	
	Shuma	490			490	
f) Periudha e zbatimit Gjatë vitit 2024 Gjatë vitit 2025 Gjatë vitit 2026		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i Bibliotekës "Marin Barleti", Muzeu Historik , Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit Institucioni Likuidues: Bashkia Shkoder				

Nr.7	P08220.Q1.O1.A7 Mbështetje për funksionimin në vazhdimësi të Muzeut Historik	Funksioni 8 Argëtim, Kultura dhe Feja N/funksioni 082 Shërbime kulturore Lloji i programit 08220 Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.
i. Situata		
<p>Muzeu Historik Shkodër ka disa godina në administrim, sic janë: Muzeu "Oso Kuka", Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës (VDK) dhe Muzeu i Kështjellës, janë elementë arkitektonikë të rëndësishëm, të cilët kanë lidhje të drejtpërdrejtë. Keto godina mirembahet në mënyrë permanente. Në themel të punës së vet, Muzeu Historik ka ruajtjen dhe promovimin e vlerave që përmban si dhe zhvillimin dhe studimin e mëtejshëm shkencor. Vitet e fundit situata e muzeut për sa i përket promovimit të vlerave kulturore ka pasur rezultate mjaft të mira, por sa i përket ruajtjes së fondeve gjendja është në përmirësim e sipër.</p> <p>Gjithashtu, planifikohet prodhimi i biletave për vizitorët, me të gjithë parametrat ligjor dhe informues, përveç informacionit bazë si: çmimi dhe destinacioni, edhe të dhëna mbi faqen zyrtare ëeb të Muzeut Historik Shkodër. Biletat janë të ndara në 3 kategori dhe çmime respektive, sipas paketes fiskale të miratuar me Vendim Keshillit Bashkiak dhe VKM nr 1497 dt 19/11 /2008 "Për shtypjen e letrave me vlerë", i ndryshuar ..</p> <p>Në muzeun e Kështjellës nevojiten punime konservuese për basorelievin e Rozafës. Gjithashtu punime konservuese për maketin e kalasë.</p> <p>Aktualisht VDK nuk disponon një fotoskaner, i nevojshëm ky për aktivitetin e përditshëm të muzeut. Është një pajisje e domosdoshme për fillimin e procesit të dixhitalizimit të materialeve arkivore të muzeut, po ashtu edhe i koleksioneve të ndryshme që muzeu disponon në fondin e bibliotekës. Me kalimin e kohës këto fonde rrezikojnë të dëmtohen, pasi shumica prej tyre kanë dhjetra vite ekzistencë. Ato janë me rëndësi të veçantë për historinë dhe vlerat që mbartin. Shumica prej tyre janë koleksione të familjeve shkodrane, të cilat janë dhuruar gjatë viteve në muze. Duke mos disponuar një pajisje të tillë, shpesh dixhitalizimi është kryer në rrugë jo profesionale dhe me mjete rrethanore. Ky do të jetë një proces që do ndihmojë shumë në modernizimin e aktivitetit të muzeut dhe do të krijojë mundësinë për pasurimin e fondit arkivor dhe krijimin e ekspozitave të reja me materiale historike dhe fotografike. Gjithashtu VDK disponon një bibliotekë të vogël në kapacitetet mbajtëse të fondit. Ky fond me libra, koleksione revistash, koleksione gazetash, materiale arkivore, albume fotografike etj, nga viti në vit sa vjen e shtohet. Kjo gjë falë dhuratave të ndryshme nga qytetarë të Shkodrës, apo nga institucione partnere, si ISKK, etj. të cilat të gjitha botimet e tyre i sjellin periodikisht pranë kësaj biblioteke. Mendimi është që të risistemohet hapësira e kësaj biblioteke, duke e kthyer në një hapësirë multifunksionale. Normalisht për këtë zgjerim të kapaciteteve të bibliotekës, ka nevojë për investim në rafte druri, tryeza apo mjete të tjera të përshtatshme për funksionin e ri, të cilat janë në përputhje me standartet e muzeologjisë moderne, kompjuter të ri apo karrige zyre etj. Aktualisht një pjesë e mirë e koleksionit mbahet e pa ekspozuar dhe në kushte jo të përshtatshme konservimi. Të gjitha materialet janë me vlerë, duke qenë se bëhet fjalë për literaturë të realizmit socialist, po ashtu edhe për literaturë të pas viteve '90 e pasur kjo sidomos me dëshmi të ndryshme të ish burgosurve politikë. Në medojmë që kjo bibliotekë në hapësirën e re të jetë shumë funksionale dhe të kthehet gradualisht një pikë referimi për lexuesit, studentët, studiuesit e të gjithë ato persona që kanë interes ta shfrytëzojnë atë. Procesi i pasurimit të fondit është në vazhdim e sipër dhe njerëzit e vlerësojnë atë.</p>		
ii. Synimi i projektit		
Ruajtja e shëndetit të objekteve dhe punonjësve; Rritje e parametrave të kushteve të vizitueshmërisë; Më shumë pastërti. Ndrësim i përshtatshëm për ekspozitat e përhershme Të shtojë vizitueshmërinë në Muze, Mbrotjtja e objekteve të trashëgimisë kulturore, përmirësimi i cilësisë së punës së përditshme.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
Vlerësimi i nevojave për ndërhyrje në ambientet e Muzeut të Kështjellës; Hartimi i konceptit teknik i sipërfaqes me metrat e kërkuar dhe sasinë e materialit që i korrespondon shërbimit; Konsulta me diferencën e biletave të vitit të kaluar, Rakordimet dhe llogaritja për vitin e ardhshëm, Përpilimi i specifikimeve teknike të biletës, e cila është një masë me vlerë e miratuar (çmimi i biletës) me VKB, sipas ligjit për Muze. Në biletë parashikohen të shënohen, të dhëna që qartësojnë numrin rendor sipas radhës së fletëbiletës, shenja dalluese, logot e secilit muze, adresa dhe faqja ëeb zyrtare si mundësi referimi të vazhdueshëm dhe standart shërbimi. Plotësim i nevojave kompjuterike dhe një teknologji më të avancuar Deumodifikator që përmirësojnë përqindjen e lagështirës		
b) Rezultatet që prisni		
Përmirësim të gjendjes dokumentuese të fondeve muzeale, duke zbatuar ligjin e funksionimit të muzeve. Shtimi i fluksit të vizitorëve, Rritja e arkëtimeve, Tërheqja e vëmendjes turistike. Vizitorët marrin shërbimin për të cilin kanë paguar. Ruajtje nga faktorët dëmtues Përmirësim i performancës në punë dhe ruajtje e trashëgimisë kulturore Konservim i trashëgimisë materiale "Ruajtje dhe mbrotjtje e trashëgimisë artistike të fondit të pinakotekës së MHSH"		
c) Aktorët e mundshëm	d) Kontributet e mundshme në projekt	

Muzeu "Oso Kuka" Muzeu i Kështjellës Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës Drejtoria e Kulturës			Bashkia Shkodër				
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Opera tive	Transf erime	Kapita le
A.1	Prodhim dhe shtypje biletash	200			200		
A.2	Blerje fotoskaner VDK	150				150	
A.3	Blerje kompiutera dhe paisje tjera TIK MH	300				300	
A.4	Mobilim zyre VDK	300				300	
A.5	Punime konservuese për basorelievin e kalasë	140			140		
A.6	Punime konservuese për maketin e kalasë	160			160		
Shuma		1250			500	750	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Opera tive	Transf erime	Kapita le
A.1	Mbështetje për funksionimin e aktivitetit dhe shërbimin në vazhdimësi të Muzeut Historik	1250			500	750	
Shuma		1250			500	750	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Opera tive	Transf erime	Kapita le
A.1	Mbështetje për funksionimin e aktivitetit dhe shërbimin në vazhdimësi të Muzeut Historik	1250			500	750	
Shuma		1250			500	750	
f) Periudha e zbatimit Janar- Dhjetor 2024 Janar-Dhjetor 2025 Janar-Dhjetor 2026		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Muzeu Historik, Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit Institucioni Likuidues: Bashkia Shkoder					

Nr.8	P08220.Q1.O1.A8 Shpenzime promovionale për aktivitetet e kultures	Funksioni 8 Argëtim, Kultura dhe Feja N/funksioni 082 Shërbime kulturore Lloji i programit 08220 Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.	
i. Situata			
<p>Gjate vitit Bashkia Shkoder me institucionet e varesise organizojne shume aktivite kulturore, te cilat per tu prezantuar denjesisht kane nevojte per promovionin e duhur. Per kete arsye eshte planifikuar nje fond ne buxhetin e Bashkise Shkoder, per te prezantuar ne nivele profesionale vlerat trashëgimisë kulturore dhe artit ne rajonin tone.</p> <p>Muzeu Historik boton çdo vit guidën e vet prezantuese , me një cilësie grafike dhe informuese të denjë per promovimin e tij. Peverc guides Muzeu Historik, gjate vitit, zhvillon aktivite kulturore te ndryshme, te cilat perfshijne materiale promovionale per te arritur sa me mire tek publiku. Fondi i parashikuar per te mbuluar promovionin e ketij institucioni është 60 mijë lek.</p> <p>Biblioteka "Marin Barleti" peverc aktivite tashme tradite, per here te pare do te organizojë nje konference me temën "Narracioni, fotografia dhe përvoja e Kujtesës, aktivitet i cili ka te beje me forume dhe biseda rreth librit, dijes, letersisë, historisë, perkthimi etj. Per promovionin e ketij aktiviteti jane parashikuar 150 mije leke. Nje aktivitet tjeter risi e Bibliotekës "Marin Barleti", i cili i dedikohet vetem letersise per femije dhe te rinj do te jete "Aktivite per femije"- Rikthimi i ketij zhanri pas shume vitesh mungese, kerkon promovionin e duhur per te nxitur talentet e reja te letersise ti bashkohen ketij aktiviteti. Fondi i parashikuar per kete aktivitet është 40 mije lek.</p> <p>Qendra Kulturore Pjeter Gaci organizon që nga viti 2000, aktivitetin nderkombetar te muzike se kultivuar Çmimi "Pjetër Gaci" , konkursi i icli promovon talentet e reja ne dege te ndryshme muzikore . Per kete aktivitet fondi i parashikuar është 25 mijë lek.</p> <p>Ahengu shkodoranë, nje aktivitet tradite dhe shume u dashur per publikun, dedikuar këngës popullore shkodorane, realizohet çdo vit me 29 Shtator ne ditën e trashëgimisë kulturore. Per kete aktivitet fondi i parashikuar është 35 mijë lek.</p> <p>Galeria e Arteve Shkoder ne kalendarin e saj te aktiviteve, organzion ekspoziten Sallonin eVjeshtës, i cili hapet ne kuader te aktiviteve te "Javes se Pavarsise" . Per kete aktivitet fondi i parashikuar është 20 mijë lekë. Personazh i ftuar, aktivitet tjeter qe organizohet nga Galeria e Arteve, ka fond te parashikuar 20 mijë lekë per promovionin Ekspozite e lire, aktivitet i cili organizohet nga Galeria e Arteve per here te dyte kete vit, ka fond te parashikuar per promovionin 10 mijë lekë.</p> <p>Aktivitetet protokollare - Fondi i parashikuar per promovion është 20 mijë leke.</p>			
ii. Synimi i projektit			
<p>Pasurimi i informacionit për rrjetin muzeal të Bashkisë Shkodër, <input type="checkbox"/></p> <p>Kthimi në traditë i botimeve permanente promovionale</p> <p>Promovimi i turizmit historik dhe kulturor.</p> <p>Plotësimi i një kërkesë të vazhdueshme të publikut vendas dhe të huaj, për pajisjen me një guidë të tillë.</p>			
iii. Aktivitetet kryesore të projektit			
<p>Përfshirja e më shumë specialistëve në hartimin e promovionit.</p> <p>Pajisja me module informative të reja dhe bashkëkohore, harta, aplikacione, website etj. <input type="checkbox"/> Krijimi i grupit të punës dhe hartimi prej tyre i programit të punës,</p> <p>Ruajtja e standartit dygjuhësh.</p>			
b) Rezultatet që prisni			
<p>Një pasqyrë më e qartë e pasurisë dhe shpërndarjes së rrjetit muzeal dhe atë të trashëgimisë për Bashkinë Shkodër.</p> <p>Një prezantim më serioz dhe i plotë i asaj çfarë kërkohet nga një guidë përgjithësuese në rrafshin kulturor.</p> <p>Promovimit të turizmit kulturor dhe hapësirës së Bashkisë Shkodër si gjurmë kulturore në rajon dhe Europë.</p>			
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt	
<p>Stafi i Muzeut Historik</p> <p>Drejtorja e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sporti</p> <p>Drejtorja e Turizmit</p> <p>Publiku vendas dhe i huaj.</p>		<p>Bashkia Shkodër,</p> <p>Donatorë të mundshëm</p>	
e) Shpenzimet e llogaritura			
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë)	Nga kjo:

		lekë)	Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferi me	Kapital e
A.1	Shpenzime per promocion	480			480		
	Shuma	480			480		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferi me	Kapital e
A.1	Shpenzime per promocion	480			480		
	Shuma	480			480		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferi me	Kapital e
A.1	Shpenzime per promocion	480			480		
	Shuma	480			480		
f) Periudha e zbatimit Janar– Dhjetor 2024 Janar –Dhjetor 2025 Janar –Dhjetor 2026		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria Ekonomike e Kulturës Muzeu Historik, Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit Institucioni Likuidues: Bashkia Shkoder					

Nr. 9	P08220.Q1.O2.A1 Zhvillimi dhe pasurimi i fondit të Bibliotekës	Funksioni 8 Argetim Kultura dhe Feja N/funksioni 082 Sherbime kulturore Lloji i programit 08220 Trashegimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Detyra kryesore e çdo biblioteke është zhvillimi dhe pasurimi i koleksioneve, përmes zgjedhjes së materialeve të shtypura dhe jo të shtypura që shërbejnë për plotësimin nevojave për edukim dhe çlodhje të komunitetit. Koleksionet e bibliotekës synojnë plotësimin e kërkesave të komunitetit në fushën e arsimit, kulturës dhe informacionit. Pasurimi në vite i fondeve të bibliotekës ka qenë dhe ngelet, një nga përparësitë kryesore të punës sonë. Zgjidhja materialeve bibliotekare , që do të punonjë koleksionet është një proces i gjatë dhe i vazhdueshëm, që kërkon jo vetëm harmonizimin e kërkesave të punonjësve që administrojnë fondet, por edhe marrjen e mendimit për zhvillimin e koleksioneve nga lexues të niveleve të ndryshme të zhvillimit kulturor; të gjinive dhe moshave. Duke qene se bibliotekat në përgjithësi kanë fonde buxhetore të kufizuara jemi përpjekur që të pasurojmë koleksionet tona përmes zgjedhjes së materialeve bibliotekare, (kryesisht libra dhe periodikë) në varësi të llojit të bibliotekës sonë dhe gjëndjes së koleksioneve. Termi tradicional "bibliotekë", përgjithësisht shënon koleksione librash dhe periodikësh, por jashtë vëmëndjes sonë nuk kanë ngelur edhe zhvillimi i koleksioneve të veçanta. Shtimi i materialeve jo libra siç cilësohen në terminologjinë e bibliotekave, është shoqëruar me krijimin në vitin 2010 të koleksioneve të veçanta të Mediatikës dhe Bibliotekës Digjitale. Biblioteka ka nëonline rreth 20.000 faqe të digjituara. Libra 9 tituj, 26 njësi; 3 koleksione revistash me 230, si dhe 1 koleksion gazete. Materiale të tjera të digjituara, që nuk janë të hedhuna në online janë rreth 17.000. Vitet e fundit kemi krijuar pikat e shërbimit me koleksioneve të hapura, si një risi e ndryshme shërbimi nga ajo tradicionale. Koleksionet e hapura kanë lehtësuar hyrjen në botën e informacionit, kryesisht për nxënësit dhe studentët, përmes kontaktit të drejtëpërdrejtë me librin. Zhvillimi dhe pasurimi i koleksioneve, të bibliotekës sonë është një detyrë e përhershme. Proçesi lidhet edhe me pasurimin e fondeve të veçanta dhe të rralla që ka kjo bibliotekë edhe në rang kombëtar. Një pjesë e mirë e koleksioneve tona janë të aksesueshme përmes katalogut elektronik. Kjo ka rritur përgjigjësinë dhe kujdesin për zhvillimin e pasurimin e koleksioneve. Bashkia Shkodër ndër vite i ka kushtuar kujdes planifikimit të fondeve buxhetore, për pasurimin e koleksioneve. Zëri i buxhetit të planifikuar për blerje librash dhe periodikësh për disa vite ka qenë 2.000.000 lekë. Vitet e fundit buxheti është përgjysmuar duke sjellur vështirësi në zhvillimin dhe pasurimin e koleksioneve. Blerja e librave ngelet sfidë pasi janë vështirësuar praktikata e blerjes përmes tenderit. Fituesit e tenderit, nuk kanë qenë seriozë. Ata që u paraqitën nuk plotësonin kërkesat tona në tituj. Një tjetër element që krijon vështirësi në zhvillimin e pasurimin e koleksioneve është edhe blerja e librave një herë në vit. Kjo procedurë është joproduktive, pasi ka edhe tituj librash që shiten dhe nuk gjenden më në treg. Problem ka qenë edhe vijueshmëria e tërheqjes së periodikut, në kushtet kur buxheti nuk lëvrohet menjëherë. Pritshmëria për fillimin e procedurës së blerjes deri në aprovimin e buxhetit ka sjellur dëmtimin e koleksioneve të periodikut. Megjithë vështirësitë koleksionet e bibliotekës zhvillohen dhe pasurohen çdo vit. Fondet e akordura jemi përpjekur t'i administrojmë duke i dhenë përparësi titujve në raport me sasinë Bashkia ka qenë financuesja kryesore për zhvillimin dhe pasurimin e fondeve, por në vite bibliotekës i janë afruar libra nga projekte të ndryshme, shoqata dhe donatorë privatë. Në vitin 2015 me fondet e akordurara të buxhetit koleksionet tona janë pasuruar me 927 njësi bibliotekare që i korespondojnë 297 tituj , ndërsa pasurimi nga të ardhurat sekondare, kryesisht dhuratat për këtë vit kanë qenë 250 njësi. Vitet e fundit koleksionet janë pasuruar nga dhuratat e shkrimtarëve të trevave shqiptare të Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi.</p> <p>Në administrimin dhe ruajtjen e fondeve te librave, rol të rëndësishëm nuk kanë vetëm lokalet ku vendosen librat, por edhe raftet.</p> <p>Me blerjen e librave ,lind nevoja e sigurimit te vendit ku do të vendosen këto libra.Shumica e bibliotekave publike kanë patur dhe vijojnë të kenë sistemin e vendosjes fikse në rafte. Materialet e shtypura (libra) vendosen sipas madhësisë në shtatë ndarjet e rafteve, nga syza e parë deri në të fundit. Të tillë janë edhe raftet e bibliotekës sonë. Ata i afrohen standarteve tradicionale të rafteve për libra dhe periodikë.</p> <p>Raftet e bibliotekës nuk afrohen me standartet e IFLA- s. Për më tepër ata tani nuk sigurojnë si duhet as ruajtjen dhe trajtimin e duhur të materialeve bibliotekare.</p> <p>Shumica e rafteve prej druri të fondeve në pjesën më të madhe janë të dëmtuar nga koha e gjatë e përdorimit.</p> <p>Të gjitha ndarjet të bazuara në material fibër, ose janë plasur, ose janë përkulur duke bërë që një pjesë e librave, sidomos ata të arkivit, të mbajnë ndarjet e njëri-tjetrit. Edhe paraqitja estetike e materialeve të shtypura në fonde të shumë për të dëshiruar. Në këtë situatë është e domosdoshme që të fillohet gradualisht zëvendësimi i tyre me rafte metalikë, shumë të qëndrueshëm në kohë dhe që garantojnë një trajtim normal të librave dhe periodikëve.</p>		
ii. Synimi i projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Zbatimi i detyrimit ligjor, mbi zhvillimin dhe pasurimin e koleksioneve. • Pasurimi i fondeve kryesore me literaturë bashkëkohore. • Pasurimi i katalogut on-line. • Përmisimi i kushteve përmes administrimit, trajtimit dhe ruajtjes së materialeve bibliotekare me synimin, që pas disa vitesh nga magazinat e librave, të kthehen pika shërbimi me fonde të hapura. 		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		

<ul style="list-style-type: none"> • Shqyrtimi i gjendjes së fondeve. Plotësimi i statistikave vjetore të hyrjeve të reja. • Evidentimi i frekuentimit vjetor të fondeve dhe lloji i literaturës së lexuar. • Ndjekja periodike e literaturës së publikuar. • Ndarja e shumës së planifikuar sipas fondeve. • Konsultimi me lexuesit. • Konsultimi me programet shkollore të literaturës së planifikuar për lexime. • Përcaktimi i fondeve ku do të ndërhyhet. • Gjetja e përkohshme e hapësirave, ku do të zhvendosen librat. • Përcaktimi i materialit të raftave. • Bërja e analizës financiare 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> • Pasurimi i fondeve me literaturë bashkëkohore. • Zgjerimi i aktivitetit të bibliotekës. • Shtimi i lexuesve. • Rritja e shërbimit ndaj komunitetit që përfshijnë të gjitha kategoritë e moshave. • Rritja e prestigjit të bibliotekës në rang kombëtar. • Përmirësimi i vendosjes dhe i trajtimit të librave. • Zgjerimi i hapësirave në dispozicion të librit. • Përmirësimi i shërbimit ndaj lexuesve. • Përpjekje për realizimin e normave të IFLA- s 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Bibliotekarët Publiku qytetar				Bashkia Shkodër.		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ	Transferime
A.1	Blerje periodiku /gazeta	100				100
A.2	Blerje librash	900				900
A.3	Blerje rafta librash	200				200
Shuma		1,200				1,200
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ	Transferime
A.1	Shpenzime per aktivitetin	1,000				1,000
Shuma		1,000				1,000
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ	Transferime
A.1	Shpenzime per aktivitetin	1,000				1,000
Shuma		1,000				1,000
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
Janar– Dhjetor 2024		Drejtoria Ekonomike e Kulturës				
Janar– Dhjetor 2025		Biblioteka "Marin Barleti"				
Janar– Dhjetor 2026		Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit				
		Institucioni Likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr.10	P08220. Q1.O3.A1 Paga dhe sigurime te personelit te Teatrit "Migjeni"	Funksioni: 8 Argetimi Kultura dhe Feja N/Funksioni 082 Sherbime Kulturore Lloji i Programit 08220 Trashegimia kulturore aktivitetet kulturore e artistike			
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit					
i. Situata					
<p>Institucioni i Teatrit "Migjeni" është një institucion varësie i Bashkisë Shkodër. Çdo aktivitet artistik që ndërmerret është në bashkëpunim dhe me miratim të administratës së bashkisë. Buxheti, niveli i pagave, nivelet e honorareve, etj me propozimin e stafit të Teatrit miratohen nga Bashkia.</p> <p>Niveli i pagave është i bazuar në VKM Nr. 1619, datë 2.7.2008, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", i ndryshuar. Bazuar ne ristrukturimin e ri te Bashkise Shkoder dhe institucioneve te saj te varesise , fondi i trasheguar nga viti paraardhes do te kaloje per mbulimin e shpenzimeve te pagave te personelit sipas struktures aktuale.</p>					
ii. Synimi i projektit					
Të arrihen objektivat e vitit 2024- 2026 për organizimin e aktiviteteve artistike, me qëllim rritjen e konkurrencës, cilësisë, promovimit të artistëve të rinj dhe gjallërimin e jetës kulturore artistike në Bashkinë e Shkodrës.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
<ol style="list-style-type: none"> Pagesa e punonjësve të Teatrit "Migjeni" <ul style="list-style-type: none"> Monitorimi i pjesmarrjes në aktivitetin e përditshëm Vlerësimi i performancës në sasi dhe cilësi të stafit Llogaritja dhe pagesa e sigurime shoqërore 					
b) Rezultatet që prisni					
<ul style="list-style-type: none"> Angazhim i plotë i stafit për realizimin e aktiviteteve të planifikuara të Teatrit dhe atyre që mund të jenë pjesë e bashkëpunimit në sajë të marrëveshjeve specifike ndërmjet Teatrit dhe Bashkisë Shkodër me institucione dhe organizata të tjera kulturore. Angazhim aktiv i aktorëve në prodhimin artistik i vlerësuar pozitiv nga spektatorët dhe juritë nëpër festivale. Rritje e numrit të aktiviteteve artistike premierë për të rinjtë dhe fëmijë. Minimalisht nga një aktivitet për këto grupmosha. Numër i spektatorëve në të gjitha aktivitetet që organizohen në Teatër, aktivitete të Teatrit dhe të organizatave e institucioneve kulturore në partneritet me teatrin, rriten nga 32 mijë në vitin 2023 në 38 mijë në vitin 2024. Të ardhurat nga aktiviteti artistik i Trupës së Teatrit "Migjeni", rriten në 3.5 milion lekë. 					
c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)		d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do tekontribuoje për këtë projekt, financiarisht etj.)			
Administrata e Teatrit "Migjeni"		Bashkia e Shkodrës			
e) Shpenzimet e llogaritura për vitin 2024					
Shpenzimet per cdo aktivitet		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga,	Sigurime	operative Kapitale
A.1	Paga personeli	2,525	2.525		
A.2	Sigurime shoqërore	603		603	
		3,128	2,525	603	
f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) Gjatë viteve 2024			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Teatri Migjeni Institucioni Likuidues. : Teatri Migjeni		

Nr.11	P08220. Q1.O3.A2 Paga dhe Sigurime Teatrit "Migjeni" dhe "Kinema Republika"	Funksioni: 8 Argetimi Kultura dhe Feja N/Funksioni 082 Sherbime Kulturore Lloji i Programit 08220 Trashegimia kulturore aktivitetet kulturore e artistike			
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit					
i. Situata					
<p>Institucioni i Teatrit "Migjeni" dhe Kinema Republika janë institucion varësie i Bashkisë Shkodër. Çdo aktivitet artistik që ndërmerret është në bashkëpunim dhe me miratim të administratës së bashkisë. Buxheti, niveli i pagave, nivelet e honorareve, etj me propozimin e stafit të Teatrit miratohen nga Bashkia.</p> <p>Teatri Migjeni ka një strukturë në të e cilën përfshihen drejtori, trupa artistike (që përfshin aktorë, instrumentistë, drejtues muzike dhe solistë).</p> <p>Niveli i pagave është i bazuar në VKM Nr. 1619, datë 2.7.2008, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësisve të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", i ndryshuar.</p>					
ii. Synimi i projektit					
Të arrihen objektivat e vitit 2024- 2026 për organizimin e aktiviteteve artistike, me qëllim rritjen e konkurrencës, cilësisë, promovimit të artistëve të rinj dhe gjallërimin e jetës kulturore artistike në Bashkinë e Shkodrës.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
Pagesa e punonjësve të Teatrit "Migjeni" Monitorimi i pjesmarrjes në aktivitetin e përditshëm Vlerësimi i performancës në sasi dhe cilësi të stafit Llogaritja dhe pagesa e sigurime shoqëror					
b) Rezultatet që prisni					
<ul style="list-style-type: none"> • Angazhim i plotë i stafit për realizimin e aktiviteteve të planifikuara të Teatrit dhe atyre që mund të jenë pjesë e bashkëpunimit në sajë të marrëveshjeve specifike ndërmjet Teatrit dhe Bashkisë Shkodër me institucione dhe organizata të tjera kulturore. • Angazhim aktiv i aktorëve në prodhimin artistik i vlerësuar pozitiv nga spektatorët dhe juritë nëpër festivale. • Rritje e numrit të aktiviteteve artistike premierë për të rinjtë dhe fëmijë. Minimalisht nga një aktivitet për këto grupmosha. • Numër i spektatorëve në të gjitha aktivitetet që organizohen në Teatër, aktivitete të Teatrit dhe të organizatave e institucioneve kulturore në partneritet me teatrin, rriten nga 32 mijë në vitin 2023 në 38 mijë në vitin 2024. • Të ardhurat nga aktiviteti artistik i Trupës së Teatrit "Migjeni", rriten në 3.5 milion lekë. 					
c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)		d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do tekonojtojë për këtë projekt, financiarisht etj.)			
Administrata e Teatrit "Migjeni" dhe Kinema		Bashkia e Shkodrës			
e) Shpenzimet e llogaritura për vitin 2024					
Shpenzimet per cdo aktivitet		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga	Sigurime	Operative Kapitale
A.1	Paga personeli	22,712	22,712		
A.2	Sigurime shoqërore	3,613		3,613	
Shuma		26,325	22,712	3,613	
e) Shpenzimet e llogaritura për vitin 2025					
Shpenzimet per cdo aktivitet		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga	Sigurime	Operative Kapitale
A.1	Paga personeli	22,712	22,712		
A.2	Sigurime shoqërore	3,613		3,613	
		26,325	22,712	3,613	
e) Shpenzimet e llogaritura për		Totali (000 lek)	Nga kjo:		

vitin 2026			Paga	Sigurime	Operative Kapitale
A.1	Paga personeli	22,712	22,712		
A.2	Sigurime shoqërore	3,613		3,613	
	SHUMA	26,325	22,712	3,613	
f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) Gjatë viteve 2024 - 2026			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Teatri Migjeni Institucioni likuidues: Bashkia Shkoder		

Nr. 12	P8220.Q1.O3.A3 Paga dhe sigurime te personelit te Drejtorise se Kultures	Funksioni 8 Argëtim, Kultura dhe Feja N/funksioni 082 Shërbime kulturore Lloji i programit 08220 Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.
--------	--	--

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:

i. Situata

Paga dhe shtesat mbi paga

Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli, bazohet tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165 datë 02.03.2016” Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar ; VKM nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” të ndryshuar; VKM nr. 187, datë 8.3.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”; i ndryshuar . Me VKB nr.63 datë 28.12.2020 “Për miratimin e buxhetit vitit të 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar për vitet 2021-2023”; i ndryshuar ,është miratuar numri i punonjësve të Bashkisë Shkodër, ndërsa niveli i pagave me VKB nr.6 dt 30.01.2018 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë ”i ndryshuar.

Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore

Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11. 05. 1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 7870, datë 13. 10. 1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Detyra kryesore e drejtorise se kultures është ruajtja dhe evidentimi i vlerave më të mira të trashëgimisë kulturore-artistike të qytetit e më gjerë dhe transmetimi i tyre në mënyrë sa më dinjitoze pa lënë mënjanë vlerat e reja që krijohen.

Gjithashtu krijon lidhje me institucione të tjera të profilit, për zbatimin e politikave kulturore lokale dhe kombëtare. Bashkërendon punën me individë, shoqata apo institucione homologe në organizimin e aktiviteteve kulturore artistike.

Për funksionimin normal të saj është i domosdoshëm parashikimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime.

ii. Synimi i projektit

Qeverisje e mirë lokale, nëpërmjet përdorimit efektiv, eficient dhe profesional të burimeve njerëzore

Shpenzime efikase për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore të nëpunësve të administratës vendore. Analizë e punës për secilin sektor me qëllim specifikimin dhe llogaritjen e saktë të ngarkesës dhe punës per secilin sektor, normimin e punës dhe detajimin më specifik të procedurave administrative Analizë sipas ngarkesës, sipas funksioneve, ligjeve sektoriale për zbatim dhe akteve nënligjore për rolin e secilës drejtori dhe sektor. Të ndërtohet një sistem i vlerësimit të performancës bazuar në rezultate dhe produkt për punën e administrimit vendor për shërbimet publike dhe administrative, për secilin punonjës, nivel i lartë drejtues, nivel i mesëm drejtues, specialist, administratorë, për çdo punonjës në strukturën e bashkisë Shkodër dhe ndërmarrjeve në varësi.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Përcaktimi i shpenzimeve për Paga, Sigurime dhe shpenzime të tjera të nevojshme për institucionin. Realizimi i procedurave të nevojshme

b) Rezultatet që prisni

Evidentimi i vlerave artistike të grupeve në rang kombëtar dhe ndërkombëtar.

Krijimi i mundësive të reja për qasje në rrjete të integruara lokale dhe ndërkombëtare.

Normalitetit në përditshmërinë e aktivitetit të QKPG.

c) Aktorët e mundshëm

Qendra Kulturore “Pjetër Gaci”. Publiku.
Komuniteti artistik, instrumentistët dhe muzikantët.

d) Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia Shkodër.

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2024	Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1 Paga	4,741	4,741				
A.2 Sigurime Shoqërore	754		754			
Shuma	5,495	4,741	754			
Shpenzimet për çdo aktivitet	Totali (mijë	Nga kjo:				

2025		lekë)	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga	4,741	4,741				
A.2	Sigurime Shoqërore	754		754			
	Shuma	5,495	4,741	754			
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga	4,741	4,741				
A.2	Sigurime Shoqërore	754		754			
	Shuma	5,495	4,741	754			
f) Periudha ezbatimit Janar – Dhjetor 2024 Janar – Dhjetor 2025 Janar – Dhjetor 2026		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Kultures Institucioni Likuidues: Bashkia Shkoder					

Nr. 13	P8220.Q1.O3.A4 Paga dhe sigurime te personelit te Qendres Kulturore "Pjetër Gaci"	Funksioni 8 Argëtim, Kultura dhe Feja N/funksioni 082 Shërbime kulturore Lloji i programit 08220 Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
